



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 20 Janar 2021

Nr: 01

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 01, PARAQITUR NË
KQZ NË DATËN 18.01.2021 DHE KA NR. 01/1 DATË 20.01.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.01.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Z. Arben QALLIU

OBJEKT: Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.01, paraqitur në KQZ në datën 18.01.2021 dhe plotësimin e KA nr.01/1 datë 20.01.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126, 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 pika 3, shkronja “a”, 18 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



V Ë R E N:

Z. Arben Qalliu, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr.01 regj, datë 18.01.2021 dhe plotësimin e kërkesës ankimore nr.01/1 datë 20.01.2021.

Në mbledhjen e datës 20.01.2021, ora 11:00 pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali, dhe diskutimit të përfaqësuesve të partive politike, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 01 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17 pika 3, shkronja “a” të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, Kërkesa Ankimore duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17 pika 3, shkronja “a” e 18 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.01, datë 18.01.2021 dhe plotësimi i kërkesës ankimore nr.01/1 datë 20.01.2021, të paraqitur nga z. Arben Qalliu.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 22.01.2020, në orën 10:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**

